



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I32-2 Prot.
Nr. Dok. 202502678/2

Tiranë 17/12/2025

Lënda: Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe trajtimit të të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në Elbasan.

Drejtuar: Z. Klevis QOSE
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Qazim HOXHA
Drejtor IEVP Elbasan

ELBASAN

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin tuaj dhe punën e stafit të institucionit që ju drejtoni në respektimin e të drejtave të të burgosurve, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit, nga inspektimi periodik që u zhvillua në IEVP Elbasan.

Inspektimi u zhvillua në datë 23.04.2025 nga Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues (**MKPT**), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, sipas Planit Vjetor të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe në nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Grupi i inspektimit përbëhej nga znj. Gloria Çarkaxhiu, znj. Nertila Qafzezi, z. Hazbi Selita dhe z. Vullnet Topalli me detyrë nd/komisionerë pranë MKPT.

Qëllimi i vizitës inspektuese ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare, si dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat themelore të tyre. Për këtë qëllim, u inspektuan ambientet në regjimin e brendshëm të institucionit në lidhje me plotësimin e kushteve materiale për jetesë normale të të paraburgosurve, zhvillimin e aktiviteteve për rehabilitimin e tyre, si dhe verifikoi zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm¹.

Vizita inspektuese ishte e pa lajmëruar dhe pa mbikqyrjen e stafit të institucionit gjatë zhvillimit të intervistave me të paraburgosurit. Grupit të monitorimit ju krijuan kushte pune nëpërmjet bashkëpunimit të frytshëm me drejtuesin dhe stafin e institucionit për arritjen e objektivave të inspektimit, në përputhje me metodologjinë e inspektimit në burgje.

Ekspertët e MKPT-së, patën akses të plotë për të inspektuar ambientet e banimit të të paraburgosurve, vendet e ajrimit, dhomat e observimit dhe të veçimit, në ambientin e infermierisë, klasat e edukimit, kuzhinë, lavanderi etj., si dhe bënë kqyrjen e dokumentacionit që administrohej nga punonjësit sipas sektorëve të institucionit. U zhvilluan gjithashtu edhe intervista konfidenciale me të paraburgosurit, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrojë gjetjet e këtij inspektimi, referuar si më poshtë vijon:

Shënime paraprake

Inspektimi në IEVP Elbasan, u zhvillua nga MKPT në kuadër të vizitave periodike që kryhen në institucionet e sistemit penitenciar dhe institucionet e tjera të privimit të lirisë së personit, në bazë të kompetencave ligjore të parashikuara në aktet kombëtare dhe ndërkombëtare për këtë qëllim.

Bazuar në metodologjinë e inspektimit, grupi i MKPT-së zhvilloi një takim me drejtorin e IEVP-së Elbasan z. Altin Ago dhe zv/Drejtorin z. Fatjon Ganaj, të cilët u vunë në dijeni të qëllimit të inspektimit.

Grupi i inspektimit, u informua nga drejtuesit e institucionit në lidhje me respektimin e të drejtave të të paraburgosurve në këtë institucion, kushtet e jetesës në dhomat e banimit, gjendjen e ambienteve të përbashkëta dhe bokset e ajrimit, funksionimi i sistemit për trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave, gjendjen shëndetësore dhe atë psiko-sociale të të paraburgosurve, etj.

¹ Me shkresë nr.K4/I17-2 prot., datë 29.07.2024 është dërguar rekomandimi për përmirësimi i kushteve dhe trajtimit të të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në Elbasan drejtuar DPB dhe IEVP Elbasan.

Nga informacioni rezultoi se:

Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.624, datë 16.12.2024 “Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, IEVP Elbasan kategorizohet **“institucion paraburgimi”** i sigurisë së zakonshme. Me urdhër nr.735, datë 04.05.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, kapaciteti zyrtar i institucionit është për trajtimin dhe **akomodimin e 160 personave**. Organika e IEVP-së Elbasan është e miratuar me urdhrin nr.68, datë 30.04.2024 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të sistemit të institucioneve të saj”. Ajo përbëhet **nga 144 punonjës**, nga të cilët 34 punonjës civil dhe 110 punonjës sigurie. Në ditën e inspektimit, në ambientet e regjimit të brendshëm **ndodheshin 148 të paraburgosur**. Referuar kapacitetit të miratuar, institucioni rezultoi të mos kishte mbipopullim. Grupi i inspektimit, mori informacion për dinamikën e popullimit në këtë institucion edhe për periudhën e fundit 6-mujore, ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. Janar 2025 - 137 të paraburgosur.
2. Shkurt 2025 - 143 të paraburgosur.
3. Mars 2025 - 150 të paraburgosur.

Sikurse konstatohet nga statistikat, nuk ka pasur raste të mbipopullimit strukturor për vitin 2025 në këtë institucion.

Nga informacioni dhe pozicionet e punës të miratuar në strukturën organike, në momentin e inspektimit institucioni nuk kishte mungesa në organikë për sa i përket punonjësve të stafit civil por kishte 7 vende vakante të punonjësve të stafit të policisë më konkretisht 4 PRM (Punonjës të Rolit të Mesëm) dhe 3 PRB (Punonjës të Rolit Bazë).

Grupi i inspektimit verifikoi edhe zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm. Sipas informacionit të raportuar nga drejtuesit e institucionit, intervistat me të paraburgosurit dhe nga inspektimi, rezultoi se:

- ✓ Ishin marrë masat për adresimin në DPB të problematikave që ka sjellë situata e mbipopullimit në këtë institucion dhe zgjedhjen e menjëhershme të tyre, kryesisht për sigurimin e krevatëve për të paraburgosurit që flenë me dyshekë në tokë.
- ✓ Ishin marrë masat nga sektori përgjegjës në institucion, për dezinfektimin 3D të ambienteve të dhomave të banimit dhe atyre të përbashkëta sipas grafikut në çdo tre mujor, me qëllim eliminimin e insekteve që dëmtojnë shëndetin e të paraburgosurve.
- ✓ Ishin marrë masat për krijimin e ambienteve të reja të palestrave dhe pajisjen e tyre me vegla force, me qëllim kalimin e kohës dhe ushtrimin fizik të të paraburgosurve.
- ✓ Ishin marrë masat pjesërisht për evidentimin e ambienteve që ishin të mbyllura dhe jashtë funksionit dhe kthimin e tyre në destinacion të aktiviteteve për të paraburgosurit apo për zhvillimin e kurseve profesionale.
- ✓ Ishin marrë masat pjesërisht për plotësimin e vendit vakant sipas organikës së institucionit në pozicionin e farmacistit por ende nuk ishin plotësuar të gjitha vendet e punonjësve të policisë së burgjeve.
- ✓ Ishin marrë masat nga sektori përgjegjës, për organizimin e veprimtarive kulturore, edukuese dhe sportive, si dhe për kurset profesionale me të paraburgosurit, me qëllim

rritjen e interesimit, ndërveprimet midis të burgosurve, si dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre, për rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në përfundim të vuajtjes së dënimit.

- ✓ Ishin marrë masat për kompletimin e klasave me orenditë e nevojshme si tavolina dhe karrige për qëndrimin ulur të të paraburgosurve dhe punonjësve të edukimit, që zhvillojnë programe individuale dhe në grup sipas përshtatjes dhe kategorive, me qëllim trajtimin psiko-social të tyre.
- ✓ Ishin marrë masat nga sektori juridik dhe sektori i çështjeve sociale të institucionit, për mbajtjen e kontakteve të përditshme me të paraburgosurit, me qëllim marrjen e ankesave/kërkesave të tyre, si dhe dhënien e asistencës të thelluar juridike për çështje që ata i shqetësojnë, në lidhje me organin e prokurorisë dhe gjyqësorin.

Ndërkohë, disa nga rekomandimet nuk ishin zbatuar, si më poshtë vijon:

- ✓ Nuk ishin marrë masat nga DPB, për miratimin e Rregullores së Brendshme të IEVP-së Elbasan, në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
- ✓ Nuk ishin marrë masat për krijimin e ambienteve (dhomave) të veçanta në çdo sektorë për tharjen e rrobave të të paraburgosurve, si dhe heqjen e litarëve në dhomat e banimit, pasi çënojnë elementët e sigurisë, por mund të shërbejnë edhe për dëmtimin e jetës, kryesisht personat që kanë probleme të shëndetit mendor.
- ✓ Nuk ishin marrë masat nga DPB, për planifikimin e fondeve buxhetore për IEVP Elbasan për riparimin e paneleve diellore dhe të chillerave, me qëllim vënien në funksion të sistemit të ngrohje/ftohjes së ambienteve në regjimin e brendshëm.
- ✓ Nuk ishin marrë masat për plotësimin e vendeve vakante sipas organikës së institucionit në pozicionin e punonjësve të policisë së burgjeve.
- ✓ Nuk ishin marrë masat nga IEVP dhe UK Elbasan, që në kushtet e mbipopullimit të sigurohet furnizimi me ujë të pandërprerë ose zgjatje e orarit të furnizimit me ujë të institucionit, për ruajtjen e higjienës personale dhe të ambienteve ku të paraburgosurit zhvillojnë aktivitetin e tyre.
- ✓ Nuk ishin marrë masat për ndryshimin e menisë së ushqimit për ta bërë atë sa më të larmishme dhe përshtatjen e vakteve ushqimore, sipas normave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore, për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, gjëndjes shëndetësore, kushteve klimaterike, besimit fetar dhe nevojave të veçanta të tyre.
- ✓ Nuk ishin marrë masat për mundësimin e takimeve fizike të paraburgosurve me familjarët në ambiente (dhoma) pa ndarje në mes me xham apo skara hekuri.

Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, rekomandimet e pazbatuara kanë të bëjnë me mungesën e fondeve buxhetore në zërin e investimeve, pavarësisht se IEVP Elbasan planifikimin vjetor të kërkesave dhe nevojave për këto investime ia ka dërguar në mënyrë të përsëritur DPB-së. Ndërsa, përsa i takon rekomandimit për heqjen e litarëve në dhomat e banimit që shërbejnë për tharjen e rrobave personale, drejtuesit e institucionit justifikohen me faktin se, mungojnë ambientet e veçanta në sektorë për tharjen e rrobave. Krijimi i këtyre ambienteve (dhomave) është detyrë e institucionit, pasi mbajtja pa kriter e tyre përbën edhe shkelje të elementëve të sigurisë.

Trajtimi i të paraburgosurve

Grupi i inspektimit, kishte për qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e personave që vuajnë dënimin në këtë institucion, identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimit të forcës fizike apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjedhjes së kërkesë/ankesave të të burgosurve, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion, komisionin për dhënien e masave disiplinore, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor, cilësinë e ushqimit, furnizimin sipas normativës me detergjente dhe mjete të higjienës personale etj.

Nga intervistat e zhvilluara me të paraburgosurit, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime për keqtrajtime dhe tejkalim të forcës fizike nga punonjësit e sigurisë të këtij institucioni. Sikurse ata pohuan në këto intervista, marrëdhëniet e stafit me të burgosurit, janë të mira dhe korrekte.

Të paraburgosurit paraqitën ankesa ndaj institucionit se në tërësi mungojnë aktivitetet kulturore, edukative dhe sportive në regjimin e brendshëm, në bashkëpunim me qendrat kulturore dhe sportive në Elbasan dhe me pjesmarrjen masive të të paraburgosurve.

Aktivitetet e vetme që zhvillohen me të paraburgosurit janë ajrimi dhe lojrat e tavolinës në klasa për çdo sektor, të cilat janë krejt të pamjaftueshme në qëllimin e tyre, ruajtjen e shëndetit fizik e mendor, si dhe rehabilitimin e kësaj kategorie. Në këtë kuadër, autoritetet dhe strukturat përgjegjëse në IEVP, kanë detyrimin që të organizojnë aktivitete të veçanta me të burgosurit, sipas nevojave dhe interesave që ata kanë. Rregullorja Europiane e Burgjeve parashikon që të burgosurve t'u organizohen veprimtari për kalimin e kohës së lirë, ku të përfshihen sportet, lojrat, aktivitetet kulturore, hobet dhe aktivitete të tjera. Gjatë veprimtarive të burgosurit duhet të lejohen të shoqërohen me njëri-tjetrin dhe bashkarisht të organizojnë kohën e lirë².

Ankesa u paraqitën dhe për mungesën e larmisë së ushqimit, e cila sipas pretendimeve të tyre, ishte e njëjtë për çdo stinë. Nga inspektimi i ambientit të kuzhinës, u konstatua se menuja javore ishte e afishuar dhe e miratuar nga komisioni i institucionit, por ajo ishte e njëjtë dhe e pandryshueshme çdo ditë të javës. Cilësia e gatimit të ushqimit ishte e mirë. Por, në dhomat e banimit, grupi i inspektimit gjeti pajisje për gatimin e ushqimit dhe të paraburgosur që gatuanin nga ushqimet e dërguara nga familjarët e tyre.

Të paraburgosurit ankoreshin për mungesën e dusheve në regjim, sipas tyre 2 poste dushi ishin të pamjaftueshëm për ruajtjen e higjienës. Përgjatë inspektimit konstatuam se të paraburgosurit ngrohnin ujin me rezistenca të cilat shërbenin edhe për ngrohjen e ambientit.

² Pika 27.6 dhe 27.7 e Rregullores Europiane të Burgjeve, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

Gjithashtu sipas të paraburgosurve shërbimi mjekësor në këtë institucion nuk ishte i rregullt dhe nuk ofrohej në kohë dhe në cilësi. Ankesa kishte dhe për vizitat mjekësore dhe ilaçet të cilat për efekt shpejtësie duhej t'i siguronin nga familjarët.

Masat mbrojtëse

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacionit lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit.

Të paraburgosurit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë të paraburgosurit.

Komisioni disiplinor ishte i ngritur dhe funksiononte me urdhër të drejtorit të institucionit³, i cili mblidhej jo më vonë se 48 orë nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore nga i paraburgosuri. Sipas dokumentacionit, mjeku i institucionit përgatiste një raport mjekësor paraprak, ku shprehej për gjendjen shëndetësore të të paraburgosurit ndaj të cilit kishte filluar procedura disiplinore. Raporti vihej në dispozicion të komisionit disiplinor dhe shqyrtohej prej tij për efekt të përcaktimit të masës disiplinore. Mjeku i institucionit jepte sqarime për gjendjen shëndetësore të të paraburgosurit nëse i kërkohej nga komisioni disiplinor, merrte pjesë në mbledhje por ishte pa të drejtë vote.

Në momentin e inspektimit në dhomat e veçimit **nuk** ndodhej asnjë i paraburgosur me masë disiplinore “përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta deri 14 ditë”, për shkelje të rëndë të disiplinës. E drejta e ankimit të masës disiplinore është e garantuar në ligj dhe të paraburgosurit e intervistuar ishin të informuar në lidhje me këtë procedurë⁴.

Dhomat e veçim-observimit dhe ambientet e tranzitit **nuk ishin** të kompletuara me materiale fjetje. Ambientet e observimit, tranzitit dhe të veçimit kishin nevojë për lyerje dhe për dizinfektim. Qëndrimi në to nuk plotësonte standardet minimale.

Të paraburgosurve ju lejohej të kryenin 8 (tetë) telefonata në muaj me familjarët, sipas parashikimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve⁵. Aparatet e telefonave ishin të vendosur në korridoret e secilit sektor e në vendet e ajrimit dhe ishin në gjendje pune. Të paraburgosurit nuk paraqitën ankesa për respektimin e orareve dhe numrit të telefonatave nga punonjësit e institucionit.

³Neni 66 i ligjit 81/2020: “Komisioni disiplinor merr vendim për dhënien e masës disiplinore pasi ka dëgjuar më parë të burgosurin ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor.

⁴Neni 67 i ligjit 81/2020: “I burgosuri ka të drejtë ta ankimojë masën disiplinore pranë komisionit të apelimit të masave disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, brenda 15 ditëve nga njoftimi me shkrim i vendimit për dhënien e masës disiplinore”.

⁵ Neni 74 i ligjit 81/2020: “Të burgosurit i lejohen 8 (tetë) herë në muaj biseda telefonike me familjarët, të afërmit dhe në raste të veçanta me të tretët, me shpenzimet e tij”.

Grupi i inspektimit, verifikoi komunikimin me telefon me institucionin e Avokatit të Popullit, në numrat e kontaktit që ishin të afishuara në hollin e secilit sektorë. Nga verifikimi rezultoi se, të paraburgosurit mund të komunikonin në çdo kohë dhe pa pagesë, sikurse parashikohet në ligjin 81/2020 dhe Rregulloren e Përgjithshme e Burgjeve.

Ambientet e takimeve me familjarët ishin në kushte të mira dhe funksionale. Ky ambient ndodhej në katin e parë të godinës A dhe kishte 7 poste për takime fizike, 2 dhoma për komunikim me “skype”, 1 dhomë për takim me avokatët mbrojtës dhe prokurorët e çështjes, si dhe 2 dhoma për takim të të paraburgosurve familjarë me familjet e tyre. Të paraburgosurit zhvillonin normalisht 4 (katër) takime me familjarët, nga të cilët 1 takim online (ose dhe më shumë në varësi të kërkesës të të paraburgosurit), brenda numrit të lejuar për takime dhe procedurave të parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Vendet e takimeve me familjarët, janë të ndara në mes me xham dhe komunikimi i të paraburgosurit me familjarët bëhet me telefon. Të paraburgosurit ngrinin si shqetësim, mungesën e kontakteve fizike me familjarët e tyre, ndaj ata kërkonin të hiqej xhami dhe të kishin mundësi kontakti fizik me familjarët.

Këtë shqetësim e ka konstatuar edhe KPT në vizitën inspektuese të zhvilluar në Shqipëri në datat 4-15 Maj 2023 dhe në raportin drejtuar autoriteteve të Qeverisë Shqiptare, ku ka theksuar se: *“është e shqetësuar të vërejtë se, pavarësisht rekomandimeve specifike të bëra në mënyrë të përsëritur nga Komiteti në të kaluarën, me përjashtim të të burgosurve të dënuar nën regjimin e sigurisë së lartë, vizitat afatshkurtra ende kryhen në kushte të mbyllura, me të burgosurit dhe vizitorët e tyre “të ndarë nga një ndarje xhami ose me shufra metalike”⁶. Në këto kushte, KPT ka përsëritur edhe një herë sygjërimin se, për të gjitha kategoritë e të burgosurve, organizimet e vizitave të hapura (për shembull, rreth një tavoline) duhet të jenë rregull, dhe ato të mbyllura përjashtim - bazuar në vendime të bazuara dhe të arsyetuara pas vlerësimit individual të rrezikut potencial që paraqet një i burgosur i caktuar. Në përfundim të analizës të këtij konstatimi KPT ka rekomanduar autoriteteve shqiptare **“të rishikojnë masat për vizita afatshkurtra në institucionet e vizituara (dhe, sipas rastit, në institucionet e tjera të burgjeve), në mënyrë që të sigurohet që vizita të tilla të kryhen, si rregull, në kushte të hapura”**.*

Dhoma e prindërimit ishte e kompletuar me orënditë e nevojshme dhe me materiale informuese, në funksion të qëllimit që ka si ambient, rritjen e ndërveprimit midis të burgosurit dhe fëmijëve të tij.

Por përgjatë inspektimit konstatuam se në këtë ambient përveç, takimeve të të paraburgosurve me fëmijët e tyre, ky ambient në kundërshtim me qëllimin e funksionimit përdorej edhe për takime me persona të rritur.

Gjithashtu, dhoma e takimeve e të paraburgosurit me avokatët mbrojtës dhe prokurorët e çështjes, ishte e pajisur me orënditë e nevojshme si tavolina pune dhe karrige, me këmbë

⁶ Janë bërë përjashtime për familjet me fëmijë të vegjël, në të cilin rast do të lejohen vizitat e hapura

të fiksuara në dysHEME, për qëndrimin ulur dhe zhvillimin e seancave të marrjes në pyetje të të paraburgosurve, sipas procedurave të parashikuara në K.Pr.P.

Kushtet higjieno-sanitare të dhomave që ndodhen në ambientin e takimeve ishin përgjithësisht të mira, por edhe këto ambiente kishin nevojë për lysterje dhe dizinfektim të vazhdueshëm.

Grup i inspektimit zhvilloi intervista më vehte me të paraburgosurit e punësuar në këtë institucion, të cilët deklarorin se kishin lidhur kontratat e punës me institucionin, sipas nevojës së institucionit dhe kërkesave të të paraburgosurve. Paga mujore kryhej nga institucioni nëpërmjet numrave të llogarive të depozituar nga të punësuarit, sipas parashikimeve në VKM-së nr.602 datë 13.10.2021 *“Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”*.

Ambientet në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit, monitorohen nga sistemi i kamerave, i cili ishte në funksion të plotë. Institucioni ka të instaluar 115 kamera. Kameran mbanin nën vëzhgim të gjitha ambientet ku kryenin aktivitetin ditor të paraburgosurit gjatë 24 orëve dhe të dhënat e tyre ruhen në një server qëndror për një periudhë 30 ditore.

Mbikqyrja me kamera e ambienteve në regjimin e brendshëm të IEVP-ve, përveç mjediseve ku çenohet privatësia, është vlerësuar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, si një masë mbrojtëse ndaj personave të privuar nga liria, për arsye se, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve; dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të burgjeve dhe paraburgimeve, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës. Gjithashtu, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

Kushtet materiale

Kushtet infrastrukturore dhe materiale në sistemin e burgjeve, lidhen ngushtësisht me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria. Plotësimi i këtyre kushteve, përbën një garanci të shtuar në arritjen e qëllimit që kanë institucionet e sistemit penitenciar, për rehabilitimin dhe ri-integrimin e të paraburgosurve në përfundim të vuajtjes së dënimit.

Në regjimin e brendshëm të IEVP-së Elbasan, ndodhen 2(dy) godina për banim (godina “A” dhe godina “B”), të cilat lidhen ndërmjet tyre me korridore të brendshme. Çdo godinë

ka katër sektorë, nga dy sektorë për secilin kat. Në katin e parë të godinës “A” ndodhen ambientet ndihmëse si dhomat e takimit me familjarët, kuzhina, dhomat e observimit, dhomat e tranzitit, dhomat për takim me prokurorët dhe avokatët mbrojtës, klasat e edukimit, si dhe ambientet për kryerjen e riteve fetare. Në katet e para të dy godinave, ndodhen gjithashtu edhe disa ambiente (dhoma) të ndërtuara sipas projektit, por ato janë të mbyllura dhe jashtë funksionit. Nga interesimi i grupit të inspektimit të drejtuesit e institucionit, u informua se, ambientet e mbyllura nuk shfrytëzohen pasi nuk lejon skema e sigurisë të institucionit të miratuar nga DPB. Për sa më lart konstatohet se nevojitet ripërcaktimi i kapaciteteve dhe marrjen e masave të menjëhershme për rishpërndarjen e të Burgosurve në mënyrë proporcionale duke respektuar standardet minimale të hapësirës dhe duke shfrytëzuar kapacitetet e institucioneve.

Në kushtet, kur të paraburgosurit ankohen për mungesën e larmishmërisë të aktiviteteve, institucioni ynë sugjeron që këto ambiente të kthehen në destinacionin për të cilin ato janë ndërtuar, duke planifikuar edhe punonjës policie shtesë në organikën e institucionit. Kjo problematikë, sipas drejtorit të institucionit, është ngritur në mënyrë të përsëritur në takimet e organizuara në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj, është duke kryer një vlerësim të përgjithshëm të ambienteve të lira që ndodhen edhe në IEVP-të e tjera, me qëllim për ti kthyer ato në ambiente funksionale dhe rekreative për të burgosurit.

Dhomat e banimit ndodhen në katin e 2-të dhe të 3-të të godinave. Ato janë me kapacitet për 2 dhe 4 persona, si dhe një dhomë në çdo sektor është për 6 persona. Sipërfaqet dhe kubaturat e dhomave të banimit janë të bollshme, duke ruajtur normat e lejuara, “*kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të burgosur*”⁷.

Dritaret e dhomave të banimit, janë me përmasa të tilla që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral për të paraburgosurit, si dhe kanë ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Dhomat e banimit ishin të kompletuara me materiale për fjetje si dyshekë, batanije, jastëk dhe çarçafë, të cilat ishin në gjendje të mirë përdorimi. Gjithashtu, në disa dhoma ku lejohej, ato ishin të pajisura me orënditë e nevojshme si tavolina, stola dhe rafte për mbajtjen e sendeve personale dhe ushqimit të të paraburgosurve. Në hapsirën e dhomave të banimit, përfshihet edhe sipërfaqja e tualeteve, të cilat mbylleshin me derë me kornizë druri dhe ishin të pajisura me nyje hidrosanitare dhe rubineta për ujë. Ato ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjeno-sanitare.

Godinat e banimit kishin komunikim me derë më vehte me bokset e ajrimit dhe fushat e sportit. Çdo godinë ka 2 bokse ajrimi dhe një fushë sporti për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive të programuara. Bokset e ajrimit kanë një pjesë e hapsirës të mbuluar, me qëllim për të qëndruar të paraburgosurit në ditët me shi dhe diell.

⁷ Neni 33, pika 4 e ligjit nr.81/2020.

Sektorët në të dy godinat e banimit, kanë të njëjtin konfiguracion me nga 10 (dhjetë) dhoma banimi, një klasë edukimi që i shërben punonjësve të sektorit të çështjeve shoqërore për trajtime individuale dhe në grup të të paraburgosurve, si dhe një ambient i përbashkët i dusheve për larjen e trupit. Në klasat e edukimit, të paraburgosurit kalonin edhe një pjesë të kohës për të ndërvepruar me njëri-tjetrin duke organizuar lojra tavoline.

Nga verifikimi i dokumentacionit u evidentua se, të paraburgosurit ishin furnizuar me detergjentë, kova, fshesa dhe letra higjienike, sipas normativa mujore nga sektori i logjistikës. Ndërkohë, ata pretendonin se këto normativa janë të pamjaftueshme dhe nuk plotësojnë nevojat e të paraburgosurve për mbajtjen e higjienës personale, për larjen e teshave dhe mbajtjen pastër të ambientit të dhomave dhe atyre të përbashkëta. Në këto kushte, të paraburgosurit detyrohen të sigurojnë detergjentë shtesë nga familjarët, duke rritur koston ekonomike të familjeve të tyre.

Furnizimi me ujë i ambienteve të institucionit kryhet nga Ndërmarrja e Ujësjiellës Kanalizimeve Elbasan, sipas një grafiku të miratuar në marrëveshjen e përbashkët me IEVP Elbasan. Furnizimit me ujë i ambienteve në regjimin e brendshëm kryhej sipas një grafiku 4 herë në ditë nga 2 orë.

Në çdo sektor ambienti i dusheve është i përbashkët. Në këto ambiente, ndodhen dy poste dushi dhe një bolier për ngrohjen e ujit. Larja e trupit kryhej rregullisht 2 herë në javë, sipas grafikut të miratuar nga drejtuesit e institucionit. Nisur nga nevojat në rritje të të paraburgosurve për larjen e trupit dhe nga koha e kufizuar e furnizimit me ujë të rrjedhshëm, **dushet nuk i përballonin kërkesat e të paraburgosurve**. Në këto kushte, disa të paraburgosur lahashin në dhomat e banimit dhe ngrohja e ujit sanitar kryhej me pajisje elektrike. Ambientet e dusheve ishin të paajrosura, dhe me lagështirë për shkak se mungonin dritaret. Gjithashtu në dhomat e banimit kishte prezencë të cilat çënojnë elementët e sigorisë, por mund të shërbejnë edhe për dëmtimin e jetës, kryesisht personat që kanë probleme të shëndetit mendor.

Nga inspektimi dhe informacioni i drejtuesve të institucionit, rezultoi se sistemi i **ngrohje/ftohjes së institucionit ishte jashtë funksionit**. Sikurse e theksuam më lart, infrastruktura në këtë institucion sjell një tjetër standard të kursimit të energjisë elektrike, nëpërmjet vendosjes të paneleve diellore në tarracat e godinave. Panelet diellore që shërbejnë për ngrohjen e ambienteve dhe të ujit sanitar, janë jashtë funksionit. Ngrohja e ujit sanitar për larjen e trupit, bëhet vetëm nëpërmjet kaldajës. Rrjeti i qarkullimit të ujit të paneleve diellore dhe linjës së ngrohjes së ambienteve është i ndryshkur dhe nuk funksionon. Funksionimi i linjës së paneleve diellore, do të ulte ndjeshëm harxhimin e e karburanteve që përdoret për ngrohjen e ujit sanitar për dushet. Gjithashtu, sistemi i chillerave që shërben për ngrohje/ftohjen e ambienteve nuk funksionon. Në këto kushte, vetëm vënia në funksionim e kaldajës nuk përballon kërkesat e të paraburgosurve për larjen e trupit, ashtu edhe për ngrohje/ftohjen e ambienteve sipas kushteve klimaterike. Sa më lart theksojmë se kjo problematikë është konstatim i përsëritur për 3 vite nga

Institucioni i Avokatit të Popullit dhe nevojitet adresim i menjëhershëm nga I.E.V.P. Elbasan.

Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, ky investim kërkon fonde shtesë në buxhetin e institucionit për ti vënë në punë, pasi do të kursente energjinë elektrike dhe njëkohësisht do të plotësonte nevojat me ujë të ngrohtë të të paraburgosurve për larjen e trupit, si dhe për mbajtjen pastër të ambienteve në regjimin e brendshëm. Sistemi i paneleve diellore, nga momenti i investimit nuk është vënë asnjëherë në përdorim, pasi fondet në dispozicion nuk kanë qenë të mjaftueshme, për ta përfunduar atë plotësisht sipas projektit. Në vite, drejtuesit e këtij institucioni kanë kërkuar DPB-së fonde shtesë për investime, me qëllim vënien në funksionim të këtij sistemi, por ende dhe sot kjo kërkesë nuk është përmbushur, për shkaqe që kanë të bëjnë me mungesën e fondeve buxhetore.

Orari i ajrimit kryhej sipas orarit të veprimeve 2 orë çdo ditë, i ndarë në kohë për secilin sektor dhe sipas godinave. Ajrimi kryhej në bokse të ndara më vehte për çdo godinë dhe nga një fushë sporti për kalçeto. Ambietet e ajrimit dhe fushat e sportit janë me hapësira të bollshme, me streha për tu mbrojtur nga dielli dhe shiu, si dhe me aparate telefoni të instaluar në secilin boks ajrimi, me qëllim që të paraburgosurit të komunikojnë me familjarët e tyre.

Në IEVP Elbasan funksiononte rregullisht njësia tregtare online, për blerjen e produkteve të nevojshme për të paraburgosurit. Nga ana e subjektit privat që ofron këtë shërbim janë të punësuar dy të paraburgosur, të cilët pasi mblidhnin çdo ditë kërkesat sipas nevojave të të paraburgosurve, kryenin porositë nëpërmjet pajisjes “iPaid” në dispozicion të tyre. Brenda 2-3 ditëve, porositë dërgohen nga subjekti privat nominalisht sipas kërkesave të të paraburgosurve.

Kuzhina e institucionit, ishte në kushte shumë të mira dhe e plotësuar me pajisjet e gatimit të standardeve bashkëkohore industriale dhe me sistem ventilimi të ajrit. Gjithashtu, enët për gatim dhe për shpërndarjen e ushqimit për të paraburgosurit ishin në gjendje shumë të mirë. Ambienti i kuzhinës ishte me hapësirë, kishte dritë dhe ajrim natyral, si dhe ishte i lyer e i pastër nga ana higjeno-sanitare. Personeli i kuzhinës ishte i plotësuar sipas organikës së institucionit me 4 (katër) kuzhinierë dhe 3 (tre) ndihmës kuzhinier nga lista e të punësuarve të paraburgosur.

Në ambientin e kuzhinës ishin të afishuara norma ditore e ushqimit, menuja për secilin vakt ushqimor dhe librezat shëndetësore të personelit të kuzhinës. **U evidentua se, menuja ishte e njëjtë për çdo ditë dhe e miratuar me firma nga anëtarët e komisionit përkatës dhe drejtori i institucionit, e cila vërtetonte ankesën e të paraburgosurve që menuja e ushqimit nuk është e larmishme.** Institucioni i Avokatit të Popullit, nisur nga konstatimet në inspektimet periodike dhe trajtimi i ankesave të të burgosurve, ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur marrjen e përgjegjësisë nga ana e IEVP-ve, që të burgosurve t’u sigurohet ushqim i shëndetshëm dhe i mjaftueshëm, i përshtatshëm për moshën, gjendjen shëndetësore, natyrën e punës, kushtet klimaterike, besimin fetar dhe

nevojat e veçanta të tij, nëpërmjet një menuje të larmishme, brenda kuotave ushqimore ditore të miratuara në urdhërin e Ministrisë të Drejtësisë.

Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe menisë së gatimit, ishin të sekretuar dhe të protokolluar. Kampionët e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike **por në të mungonte etiketimi**, sipas vakteve ushqimore. Gjithsesi, pavarësisht disa pretendimeve të ngritura nga të paraburgosurit, grupi i inspektimit konstatoi se, ushqimi ishte i gatuar sipas vakteve në bazë të menisë ditore dhe ishte i një cilësie të mirë.

Përgatitja e ushqimit dhe shpërndarja sipas sektorëve të të paraburgosurve, kryhej me vaska me kapak dhe enë kuzhine të nikeluara e të pastra. Shpërndarja e ushqimit në secilën godinë banimi kryhej me karroca (të cilat ishin në gjendje të rregullt) dhe me krahë nga njëri sektor në tjetrin, nga shpërndarësit e ushqimit të punësuar.

Regjimi dhe aktivitetet

Orari i veprimeve ishte i miratuar nga drejtori i institucionit dhe ishte i afishuar në vende të aksesueshme nga të paraburgosurit, në klasat e edukimit dhe në korridoret që të nxirrnin për në ambientet e ajrimit. Orari përfshin tërë aktivitetin ditor, përfshirë këtu dhe veprimtaritë me karakter social-kulturor e sportiv, që zhvillohen sipas programit me të paraburgosurit.

Spektori i çështjeve shoqërore zhvillonte veprimtaritë me të paraburgosurit sipas planit mujor të miratuar nga drejtori i institucionit. Klasat e edukimit ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme, si dhe kishin ajrim e dritë natyrore. Në klasa kishte raftë për libra artistik, por kishte mungesa në afishimin e të drejtave të të burgosurve, si dhe pajisjen me orëditë e nevojshme **si tavolina dhe karrige**, të cilat do të mundësonin më së miri zhvillimin e programeve individuale psiko-sociale dhe në grup me të paraburgosurit. Ambienti i klasave, përdorej njëkohësisht dhe si një ambient për kalimin e kohës së lirë për të paraburgosurit, në përfundim të orarit të ajrimit.

Nga intervistat, u evidentua se të paraburgosurit zhvillonin aktivitete të reduktuara në ambientet e ajrimit, si lojra në kalçeto dhe lojra tavoline. Në sektorin ambienteve të përbashkëta kishte një palestrë, dhe ishte kompletuar me vegla force.

Pavarësisht ambienteve dhe programeve mujore të aktiviteteve, të paraburgosurit ngritën me shqetësim mungesën e larmisë së aktiviteteve social-kulturale dhe sportive, me pjesëmarrjen e gjerë të të paraburgosurve, aktivitete të cilat do të ndikonin në rritjen e aftësive ndërvepruese midis të paraburgosurve, si dhe në zhvillimin e aftësive fizike dhe psikike të tyre.

Avokati i Popullit ka shprehur në mënyrë të përsëritur shqetësimin për mungesën e aktiviteteve të larmishme me të burgosurit, pasi një orar i balancuar midis punës, edukimit

dhe sportit, është me rëndësi kryesore për mirëqënien e të burgosurve që vuajnë dënimin në institucionet e sistemit të burgjeve.

Lidhur me këtë çështje Komiteti European për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtërues (KPT) pranë Këshillit të Europës, në rekomandimet e tij ka theksuar se, të burgosurit nuk mund të lihen të vuajnë për javë, e ndoshta muaj, të mbyllur në qeli, pavarësisht se sa të mira mund të jenë kushtet materiale në qeli. Ndaj në këto kushte, *“KPT konsideron se duhet synuar të sigurohet që të gjithë të ndaluarit në institucionet përkatëse të mund të kalojnë një pjesë të arsyeshme të ditës (8 orë ose më tepër) jashtë qelive, të angazhuar në aktivitete të qëllimshme të natyrave të ndryshme”*⁸.

Gjithashtu edhe Rregullorja Evropiane e Burgjeve e përforcon qëndrimin e KPT-së, duke përcaktuar në pikat 25.1 dhe 25.2 të saj se: *“Regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*⁹.

Nga studimi i dosjeve psiko-sociale rezultoi se, ato ishin të plotësuar sipas rubrikave që përmban dosja. Punonjësit e sektorit të çështjeve sociale, në dosjet personale të secilit të paraburgosur, kanë të pasqyruara programet individuale të trajtimit, si dhe pjesëmarrjen e aktivizimit të tyre në aktivitetet e përbashkëta apo diskutimet në grup për tema sociale. Seancat këshillimore individuale zhvillohen në klasat e edukimit të çdo sektori, ndërsa aktivitetet kulturore e sportive zhvillohen në ambientet e ajrimit të secilës godinë. Gjatë kohës së inspektimit, specialistët e sektorit të çështjeve sociale, ndodheshin në klasat e edukimit për secilin sektor duke zhvilluar takime me të paraburgosurit, sipas kërkesës së tyre.

U evidentua gjithashtu se, gjatë periudhës një vjeçare midis 2 inspektimeve ishin zhvilluar disa kurse profesionale me të paraburgosur që kishin shfaqur interesimin e tyre, në profesione si kuzhiner, elektrikist dhe mekanik në bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional në Elbasan. Në momentin e inspektimit ishte duke u zhvilluar “Kursi për Kuzhinë”, ku ishin regjistruar 7 të paraburgosur nën drejtimin e instruktorese të dërguar kjo qendër. Avokati i Popullit vlerëson e stimulon organizimin e kurseve që të aftësojnë të paraburgosurit me njohuri profesionale të nevojshme.

Stafi i sektorit të çështjeve shoqërore, sipas strukturës së re organike përbëhej nga 4 punonjës, nga të cilët 1 shëf sektori dhe 3 specialistë me profesion psikolog e punonjës social dhe nuk kishte mungesa në staf.

⁸ <https://rm.coe.int/16806ce94e>

⁹Rregullorja e Evropiane e Burgjeve

<http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

Shërbimi Shëndetësor

Shërbimi shëndetësor për të paraburgosurit në këtë institucion, ofrohej pjesërisht sipas standardeve të parashikuara në aktet ligjore dhe ato ndërkombëtare, pasi të burgosurit gëzojnë të njëjtat standarde të kujdesit shëndetësor, të cilat janë në dispozicion edhe të komunitetit.

Struktura organike e personelit shëndetësor të institucionit, përbëhej nga 8 punonjës, nga të cilët 1(një) mjek i përgjithshëm, 1(një) stomatolog, 1(një) farmacist dhe 5 (pesë) infermierë. Mjeku ishte i punësuar me kohë të pjesshme 4 orë në ditë, por sipas kontratës të punës mjeku paraqitej menjëherë në çdo kohë në institucion për rastet e urgjencave, si dhe në rastet e kërkesave apo nevojave emergjente shëndetësore që mund kishin të paraburgosurit e institucionit.

Ambienti i spitalit ndodhet në godinën kryesore të regjimit të brendshëm, i veçuar nga ambientet e banimit. Ky ambient ka në përbërje dhomën e vizitave të mjekut, dhomën e infermierisë, dhomën e terapisë, dhomën e stomatologut, farmacinë, si dhe 3(tre) dhoma me shtretër për shtrimin e pacientëve të sëmurë në rastet e urgjencave, sipas rekomandimit të mjekut të institucionit. Dhoma e vizitave mjekësore dhe ato për shtrimin e pacientëve, janë me hapësirë dhe sipërfaqe të mjaftueshme, të ajrosura dhe me ndriçim natyral dhe artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Dhoma e mjekut ishte e plotësuar me një krevat, tavolinë, karrige dhe dollap për mbajtjen e mjeteve të punës të mjekut. Kabineti stomatologjik gjithashtu, ishte i plotësuar me kabinetin e punës, duke përfshirë edhe poltronin e ri. Ndërsa infermiera, ishte e pajisur me raftet për mbajtjen e medikamenteve për të sëmurët kronikë dhe për rastet e urgjencave. Në mungesë të farmacistit detyrën e kryente një nga infermierët, i cili ishte përgjegjës për shpërndarjen e ilaçeve të sëmurëve, sipas rekomandimeve të mjekut të institucionit. Ambientet e spitalit ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare.

Farmacia e institucionit ishte e furnizuar me medikamente nga DPB-ja. Për të sëmurët kronikë, farmacia furnizohej rregullisht me ilaçe sipas skemës trepalëshe mes institucionit, depos farmaceutike dhe Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (DRFSKDSH). Ndërsa për të sëmurët akutë, ilaçet siguroheshin nga vetë institucioni, përmes blerjeve të drejtëpërdrejta me fondet e destinuara në buxhetin e institucionit.

Vizitat mjeksore nga mjeku i institucionit, kryheshin sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, me kërkesë të të paraburgosurve dhe miratim të drejtorit të institucionit. Në rastin e vizitave mjekësore pranë mjekëve specialistë në Spitalin Rajonal Elbasan, pas lëshimit të rekomandimit nga mjeku i institucionit dhe miratimit nga drejtori i institucionit, bëhej planifikimi dhe pacienti shoqërohej nga forcat e sigurisë për kryerjen e vizitave mjeksore. Nga intervistat me të paraburgosurit, nuk u

paraqitën ankesa në lidhje me vonesa në kryerjen e vizitave mjekësore në Spitalin Rajonal të Elbasanit apo në Spitalin e Burgjeve në Tiranë.

KPT në përfundim të vizitës inspektuese të kryer në Shqipëri në 4-15 maj 2023, **ka rekomanduar që të rishikohen masat për aksesin e personelit të kujdesit shëndetësor në burgjet e vizituara në mënyrë që të shmanget që personeli i burgut të veprojë si ndërmjetës**. Kjo mund të arrihet, duke organizuar vizita ditore të personelit të infermierëve në ambientet e burgut për të mbledhur kërkesat për konsulta mjekësore, ose duke vendosur kutitë e dedikuara të mbyllura për kërkesat për konsulta në të cilat të kenë akses vetëm punonjësit e sektorit të kujdesit shëndetësor.

Në rastet e disa vonesave për kryerjen e vizitave mjekësore në institucionet publike shëndetësore, drejtuesit e institucionit dhe personeli shëndetësor informuan se, ato kryhen bazuar në procedurën e sigurisë për shoqërimin e të burgosurit, duke ruajtur konfidencialitetin e plotë të lëvizjeve dhe shmangur çdo lloj komunikimi dhe kontakti të të paraburgosurit me jashtë. Gjithashtu, vizitat pranë qendrave spitalore komunitare kryheshin menjëherë pas konfirmimit në sistem të orës dhe dates së zhvillimit të vizitës nga mjeku specialist.

Në lidhje me këtë çështje, qëndrimi i Avokatit të Popullit është që të burgosurit duhet të kenë akses të plotë dhe në çdo kohë te mjeku, për shkak të pamundësisë të zgjedhjes dhe mungesës të alternativave për marrjen e shërbimit shëndetësor. Ky qëndrim është i njëjtë edhe me rekomandimet e KPT-së (CPT) për këtë çështje, ku shprehet qartë se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se, “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”*.

Kujdesit shëndetësor ndaj të burgosurve në IEVP, si dhe institucionet përgjegjëse për garantimin e shëndetit për të burgosurit jashtë sistemit të burgjeve, është kushtuar rëndësi e veçantë edhe në Rregulloren Evropiane të Burgjeve, ku thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*¹⁰.

Institucioni ishte i pajisur me ambulancë të re, me qëllim shoqërimin e të sëmurëve në rastet e urgjencave për në Spitalin Rajonal të Elbasanit, sipas kushteve për sigurinë e shëndetit dhe atë fizike të këtyre personave.

Nga këqyrja e dokumentacionit të personelit shëndetësor, u konstatua se në dhomën e mjekut ndodhej regjistri i vizitave mjekësore, regjistri i evidentimit të rasteve të dhunës

¹⁰ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

dhe kartelat klinike të të paraburgosurve dhe administroheshin prej tij. Në dhomën e infermierëve ndodhej regjistri i shërbimit 24 orë, me informacione për gjëndjen shëndetësore të të paraburgosurve, si dhe regjistri i shpërndarjes së medikamenteve për të sëmurët kronikë, të cilët administroheshin nga personeli infermierëve sipas turneve. Regjistrat dhe formatet e kontrollit mjekësor ishin sipas kërkesave të protokolleve shëndetësore për llojet e sëmundjeve, të plotësuar sipas rubrikave dhe të sekretuar.

U evidentua gjithashtu se, të paraburgosurit ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Për shkak të dinamikës së lëvizjeve të shpeshta të të paraburgosurve, kishte disa raste të mungesave të librezave shëndetësore, por ishin duke u plotësuar nga personeli mjekësor i institucionit.

Përsa më sipër, në mbështetje të pikës 3, neni 63 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; germa “b”, neni 21 i ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe, pika 1 dhe 2/b, neni 81 i ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku thuhet se: “1. Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim mekanizmi kombëtar, i krijuar në përputhje me legjislacionin për Avokatin e Popullit, mbikëqyr zbatimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve; 2. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca:*

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”;

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme nga DPB, për miratimin e Rregullores së Brendshme të IEVP-së Elbasan, në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
2. Marrjen e masave të nevojshme nga DPB, për planifikimin e fondeve buxhetore për IEVP Elbasan për riparimin e paneleve diellore dhe të chillerave, me qëllim vënien në funksion të sistemit të ngrohje/ftohjes së ambienteve në regjimin e brendshëm dhe shmangien e përdorimit të rezistencave për ngrohjen e ujit e ambienteve të dhomave për të parandaluar çdo rrezik të mundshëm për jetën e të burgosurve.
3. Marrjen e masave të nevojshme për furnizimi me ujë të pandërprerë ose zgjatje e orarit të furnizimit me ujë të institucionit, për ruajtjen e higjienës personale dhe të ambienteve ku të paraburgosurit zhvillojnë aktivitetin e tyre.
4. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambienteve (dhomave) të veçanta në çdo sektorë për tharjen e rrobave të të paraburgosurve, si dhe heqjen e litarëve në

- dhomat e banimit, pasi çënojnë elementët e sigurisë, por mund të shërbejnë edhe për dëmtimin e jetës, kryesisht personat që kanë probleme të shëndetit mendor.
5. Marrjen e masave për shtimin e numrit të dusheve për çdo sektor kjo në proporcion me numrin e të paraburgosurve.
 6. Marrjen e masave për plotësimin e vendit vakant të mjekut me kohë të plotë me dy mjekë part time si dhe plotësimin të vendit vakant të farmacistit.
 7. Marrjen e masave të nevojshme nga IEVP Elbasan, për plotësimin e vendeve vakante sipas organikës së institucionit për punonjësit e policisë së burgjeve.
 8. Marrjen e masave dhe nxjerrjen e përgjegjësi lidhur me mosfunksionimin sipas qëllimit për të cilën është krjuar dhoma e prindërimit si dhe mundësimin e takimeve fizike për të gjithë të paraburgosurit me familjarët në ambiente (dhoma) pa ndarje në mes me xham apo skara hekuri.
 9. Marrjen e masave të nevojshme nga sektori përgjegjës për organizimin e veprimtarive kulturore, edukuese dhe sportive, si dhe për kurset profesionale me të paraburgosurit, me qëllim rritjen e interesimit, ndërveprimin midis të burgosurve, si dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre, për rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në përfundim të vuajtjes së dënimit.
 10. Marrjen e masave për pajisjen e dhomave të veçimit observimit dhe ambienteve të tranzitit me materiale fjetje si dhe lyerjen dhe dizinfektimin.
 11. Marrjen e masave të menjëhershme, për ndryshimin e menisë së ushqimit për ta bërë atë sa më të larmishme dhe përshtatjen e vakteve ushqimore, si dhe etiketimin e kampionëve ushqimorë.
 12. Marrjen e masave të nevojshme, për kompletimin e klasave me orëditë të nevojshme si tavolina dhe karrige për qëndrimin ulur të të paraburgosurve dhe punonjësve të edukimit, që zhvillojnë programe individuale dhe në grup sipas përshtatjes dhe kategorive, me qëllim trajtimin psiko-social të tyre.
 13. Marrjen e masave të menjëhershme, për planifikimin dhe shpërndarjen e drejtë të normativave për konsum dhe detergjente për çdo të burgosur.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditë sipas nenit 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

**Ahmet PRENÇI
d.v**